



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1714/24 Datë: 20/08/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 127-të, mbajtur me datë 12.08.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Zgjatet periudha e riakreditimit e Fakultetit të Arteve të Universitetit të Prishtinës për periudhën një (1) vjeqare 01.10.2024 deri 30.09.2025, për programet e studimit:
 1. *Bachelor i Muzikës, BMus, 240 ECTS R (me 2 specializime): 1. Pedagogji e Përgjithshme Muzikore; 2. Kompozim.*
 2. *Master i Muzikës në Performim, MMus, 60 ECTS R, (me 5 specializime): 1. Piano; 2. Dirigjim; 3. Solo këndim; 4. Instrumente me harqe dhe tela; 5. Instrumente frymore.*
 3. *Master i Muzikës në Kompozim, MMus, 120 ECTS, R*
 4. *Artet Vizuale, BA, 240 ECTS, R (me 7 specializime): 1. Pikturë; 2. Skulpturë; 3. Grafikë; 4. Ilustrim dhe Vizatim; 5. Art Konceptual dhe Media të reja; 6. Dizajn i komunikimit; 7. Dizajn i Inovacioneve.*
 5. *Artet Vizuale MA, 60 ECTS R, (me 6 specializime): 1. Pikturë; 2. Skulpturë; 3. Grafikë; 4. Ilustrim dhe Vizatim; 5. Art Konceptual dhe Media të reja; 6. Dizajn dhe multimedia.*
 6. *Artet Dramatike, BA, 240 ECTS R, (me 7 specializime): 1. Aktrim; 2. Regji Teatri; 3. Regji filmi dhe TV; 4. Dramaturgjia dhe skenar filmi dhe TV; 5. Dizajn skene dhe kostumografi; 6. Produksion; 7. Kamerë dhe Montazh.*
 7. *Artet Dramatike MA, 60 ECTS R, (me 7 specializime): 1. Aktrim; 2. Regji Teatri; 3. Regji filmi dhe TV; 4. Dramaturgjia dhe skenar filmi dhe TV; 5. Dizajn skene dhe kostumografi; 6. Produksion; 7. Kamerë dhe Montazh.*
- II. Për këtë periudhë të riakreditimit vlejné kriteret dhe kuotat e njëjta sikurse në vendimin e fundit me të cilin ishte ri/akredituar ky program.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Fakulteti i Arteve në Universitetin e Prishtinës brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Bachelor i Muzikës, BMus, 240 ECTS R (me 2 specializime):</i> 1. Pedagogji e Përgjithshme Muzikore; 2. Kompozim.	Florita Raifi, Misbah Kaçamaku, Nezahete Shala, Kreshnik Aličkaj, Drinor Zymberi, Zana Basha
2.	<i>Master i Muzikës në Performim, MMus, 60 ECTS R, (me 5 specializime):</i> 1. Piano; 2. Dirigjim; 3. Solo këndim; 4. Instrumente me harqe dhe tela; 5. Instrumente frymore.	Besa Llugiqi, Lule Elezi, Alma Bektashi, Arianit Shehu, Blerim Grubi, Shkumbin Bajraktari, Merita Juniku
3.	<i>Master i Muzikës në Kompozim, MMus, 120 ECTS, R</i>	Valton Beqiri Dafina Zeqiri Nushi
4.	<i>Artet Vizuale, BA, 240 ECTS, R (me 7 specializime):</i> 1. Pikturë; 2. Skulpturë; 3. Grafikë; 4. Ilustrim dhe Vizatim; 5. Art Konceptual dhe Media të reja; 6. Dizajn i komunikimit; 7. Dizajn i Inovacioneve.	Agnes Nokshiqi, Blerdi Malushi Blerta Basholli, Drita Begolli, Ismet Sjarina, Isak Duraki, Seadet Beqiri, Zeni Ballazhi
5.	<i>Artet Vizuale MA, 60 ECTS R, (me 6 specializime):</i> 1. Pikturë; 2. Skulpturë; 3. Grafikë; 4. Ilustrim dhe Vizatim; 5. Art Konceptual dhe Media të reja; 6. Dizajn dhe multimedia.	Adem Rusinovci, Guri Cavdarbasha Ismet Jonuzi, Majlinda Kelmendi Mirsad Lushtaku, Suad Rama, Yllka Fetahaj
6.	<i>Artet Dramatike, BA, 240 ECTS R, (me 7 specializime):</i> 1. Aktrim; 2. Regji Teatri; 3. Regji filmi dhe TV; 4. Dramaturgjia dhe skenar filmi dhe TV; 5. Dizajn skene dhe kostumografi; 6. Produksion; 7. Kamerë dhe Montazh.	Arbënesha Nixha, Arian Krasniqi Burim Arifi, Ekrem Xani Elmaze Nura, Hazir Haziri, Ilire Vinca Latif Hasolli, Luan Jaha Luan Kryeziu, Zymer Kelmendi

7.	Artet Dramatike MA, 60 ECTS R, (me 7 specializime):	Agnes Nokshiqi,
	1. Aktrim;	Blerdi Malushi
	2. Regji Teatri;	Blerta Basholli,
	3. Regji filmi dhe TV;	Drita Begolli,
	4. Dramaturgjia dhe skenar filmi dhe TV;	Ismet Sjarina,
	5. Dizajn skene dhe kostumografi;	Isak Duraki,
	6. Produksion;	Seadet Beqiri,
	7. Kamerë dhe Montazh.	Zeni Ballazhi

KShC fillimisht kishte vendosur që të refuzohen programet e fushës së Arteve për shkak të mungesës së bazës ligjore përkatësisht zbrazëtisë ligjore për këtë çështje (kalimi i afatit të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.02/2019 me datë 31.01.2019).


Mirëpo më pas KShC pas pranimi të Udhëzimit të ri administrativ (MASHTI) 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve studimore si dhe programeve nga radhët e komuniteteve jo shumicë në procesin e akreditimit dhe riakreditimit të institucioneve të arsimit të lartë, nënshkruar me datë 25.07.2024 i cili adreson edhe çështjen e bartësve të programeve të arteve, ka marrë në rishqyrtim kërkesën për programet e bashkëngjitura në tabelë me bartësit përkatës dhe pas rishqyrtimit ka arritur në përfundim të riakreditoj me kusht programet e lartpërmendura për një periudhë një (1) vjeqare.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 127-të, mbajtur me datë 12.08.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Fakulteti i Arteve në Universitetin e Prishtinës dhe duke u bazuar në kompetencat ligjore, autorizimet dhe diskrecionin, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Arteve;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë